



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.232/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së flamurëve në hapësira publike përkatësisht në shtylla të ndriçimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e parregullt ankesa Anr.232/2019 e datës 05.10.2019, e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së flamurëve në hapësira publike përkatësisht në shtylla të ndriçimit.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën pretendon se me datë 04.10.2019, në rrugën kryesore “Nënë Tereza”, në Komunën e Fushë Kosovës, në afërsi të postës së qytetit, monitoruesi ynë ka hasur në flamuj të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të vendosur në hapësira publike përkatësisht në shtylla të ndriçimit, kështu duke është vepruar në kundërshtim me nenin 33 par.1 pika b) të LZP-së, këto pretendime vërtetohen në bazë të fotografive që i kemi bashkangjitur ankesës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Paneli nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), është e parregullt, sepse nuk është nënshkruar nga parashtruesi i ankesës, andaj si e tillë e njëjta nuk i plotëson elementet e kërkuara sipas nenit 5 par.6 të Rregullës Nr.02/2015, e cila përcakton se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi dhe*

në emër të tij nga i autorizuari. Në rastet kur ankuesi/ja është parti politike, kualicion, iniciativë qytetare ose çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nëshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet ku kjo është e mundëshme, me çfarëdo dispozite ligjore në fuqi”.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 232/2019 më datë 06.10.2019

Kryesues i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*

